



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.415/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Ramush Bardiqi dhe Hidajete Gashi Alaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ilir Keka, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Klinës, nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura në 12 Tetor 2025, me datë 07.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZL.Anr.415/2025, e datës 06.11.2025, e parashtruar nga kandidati për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Klinës, Ilir Keka nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura në 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 06.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Klinës, Ilir Keka, nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se ka parregullsi të konstatuara në qendrën e votimit shkolla "Dëshmorët" në Volljakë për kutitë e votimit 0810/01 dhe 0810/02. Tutje, parashtruesi i ankesës thekson se në këtë qendër të votimit e kanë votuar familjarë mirëpo votat e tij nuk janë evidentuar. Andaj, parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP që të urdhëroj KQZ-në të hap kutitë e votimit 0810/01 dhe 0810/02 në Volljakë në menyrë që të behët verifikimi i vërtetësisë së procesit dhe evidentimi i mundshëm i parregullsive. Në ankesë, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa dëshmitar dhe numrat e tyre personal që sipas tij mund të vërtetojnë pretendimet e tij në ankesë.

Në përgjigje në ankesë të KQZ-së, theksohet se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025,

Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në QKN, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore nr.16/2024 për QKN. KQZ, njofton se procesi i numërimit të votave në QNR është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore nr.14/2024, QNR ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar.

Pala ankuese, ndër të tjera, ka pretenduar se disa nga familjarët e kanë votuar për të mirëpo, sipas tij mungojnë votat e tyre. Ky pretendim nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë dhe në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës dhe poashtu fletëvotimi nuk mund të identifikohet emri i votuesit. Me tutje, KQZ thekson se sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në pritshmërinë dhe deklaratimet e disa personave, duke theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Po ashtu, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se palët ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova relevante që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e tij për mungesën e votave të pretenduara në vendvotimin e lartcekur. Në pajtim me nenin 106 të LZP-së, personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit cenohen me vendimin e KQZ-së lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, ka të drejtë të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e tyre. KQZ, me vendimin e datës 03.11.2025 nr.01/3093/2025, ka shpallur Rezultatet Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kuvendet Komunale, të mbajtura me 12 Tetor 2025, afati për paraqitjen e ankesave ka filluar me 03.11.2025 në ora 15:00. Andaj, ankesa e palës ankuese konsiderohet e pasafatshme.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

- Ankesa është e pasafatshme

Në këtë rast, PZAP nga shqyrtimi i shkresave të lëndëve, ankesës të ankuesit, përgjigjen në ankesë të KQZ-së konstatoj se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën me datë 06.11.2025, ku ka pretenduar se ka mungesë të votave, ndërsa sipas përgjigje nga KQZ dhe Provave të Bashkangjitura Rezultatet Përfundimtare nga KQZ-ja janë shpallur në datë 03.11.2025.

Me dispozitën e nenit 106 paragrafi 3, në mënyrë decitive parashihet se ” *Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë cenuar me vendimin e KQZ-së, sa i përket shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, mund të parashtrojë ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e tij* ” të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo kuptohet se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parashihet që “ *Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara*”, ndërsa nën paragrafi 5.17. parasheh që “*Lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga KQZ*”. Neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parasheh që: “*PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.*”

Paneli, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga kandidati për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Klinë, Ilir Keka nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të mungesës së votave, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat e lartcekura, andaj PZAP vendosi që ankesën e ankuesit ta hedh si të pasafatshme, pasi që KQZ ka shpallur rezultatet përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me 12.10.2025, me datë 03.11.2025, afati për paraqitjen e ankesave ka filluar me 03.11.2025 në ora 15:00, ndërsa ankesa është paraqitur në datë 06.11.2025 në ora 10:50, më çka vërtetohet se ankesa nuk është paraqitur brenda afatit ligjor prej 48 orëve, ashtu siç parashihet me nenin 106, paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Pretendimet e tjera të parashtruesit të ankesës PZAP, përkatësisht Paneli nuk i ka vlerësuar, sepse secila ankesë fillimisht ekzaminohet në drejtim të lejueshmërisë dhe afatshmërisë dhe nëse rezulton se është e palejueshme apo e pasafatshme PZAP, përkatësisht Paneli e hedh poshtë pa u lëshuar në përmbajtje e ankesës dhe pretendimeve ankimore sikurse në rastin konkret. Të gjitha deklaratimet dhe pretendimet e subjektit ankues edhe sikur të qëndronin apo të merreshin të mirëqena nuk mund të shqyrtohen dhe ekzaminohen, meqenëse aspekti i afatshmërisë është veprim paraprak i cili nuk ka mundësi të anashkalohet.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 106 paragraf 3 i LZP-së, nenit 117 paragrafi 3, dhe nenit 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës lidhur me nenin 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.17, neni 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.415/2025, datë 07.11.2025

Kryesues i Panelit

Arsim Hamzaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.